



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2022

Datë: 29.04.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës duke u bazuar në nenin 12, shkronja (d), nenin 17, paragrafi 1, shkronja (b), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2002”, e në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1.2, pika 1.2.1, nenit 6, paragrafi 1.2, pika 1.2.1, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.1, nenit 11 dhe nenit 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.30/2013” dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe Vendimit për dhënien e pëlqimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Gjakovës 2022-2030 Nr. 1622-2/22 të datës 04.04.2022 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e konform nenit 55 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01 Nr.011-10 të datës 26.12.2008, në mbledhje e mbajtur me dt.29.04.2022, pas diskutimeve lidhur me pikën e 5 të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Komunal 2022-2030, i Komunës së Gjakovës , e miratoj këtë :

VENDIM

Për Planin Zhvillimor Komunal 2022-2030

Neni 1

MIRATOHET “Plani Zhvillimor Komunal” për Komunën e Gjakovës për periudhën 8 (tetë) vjeçare 2022-2030 (në tekstin e mëtejme PZHK), si në projekt-planin multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor duke përfshirë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për tërë territorin e Komunës së Gjakovës me sipërfaqe të përgjithshme 587 km².

Neni 2

2.1 “Plani Zhvillimor Komunal i Gjakovës 2022-2030” përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tërë territorin e Komunës, mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës.

2.2 Pjesë përbërëse e këtij vendimi është “Plani Zhvillimor Komunal i Gjakovës 2022-2030” i hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-174 për planifikim hapësinor “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013”, Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe Vendimit për dhënien e pëlqimit për miratimin e “Plani Zhvillimor Komunal i Gjakovës 2022-2030” Nr. 1622-2/22 të datës 04.04.2022 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë.

2.3 “Plani Zhvillimor Komunal i Gjakovës 2022-2030” përmban pjesën tekstuale dhe grafike, Vendimin Nr. 440/21 të datës 26.02.21 për Pëlqimin Mjedisor të Raportit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Raportin e shqyrtimit publik e që janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

Të gjitha planet tjera komunale që nuk janë në kundërshtim me “Planin Zhvillimor Komunal të Gjakovës 2022-2030” mbesin në fuqi deri në miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjitha organet e Komunës së Gjakovës, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Gjakovë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr 03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28/2008”, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores Nr. 10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër të protokollit 01 Nr 011-3856/2008 të datës 30.06.2008 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2006-2015+.

Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit

